



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1058/4 prot.

Tiranë, më 24.7 2026

V E N D I M
Nr. 25, datë 24.7.2026

P Ë R
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 24.7.2026,

V E N D O S I:

- I. Të bëhen këto shtesa e ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin nr.1, datë 31.1.2017, i ndryshuar:
1. Aneksi nr.11 "Kriteret e përzgjedhjes së pedagogëve dhe trajnerëve/ekspertëve të Shkollës së Magjistraturës", ndryshon si vijon:
 - Në pikën 1 "Objektivat e Shkollës së Magjistraturës për pedagogët dhe trajnerët/ekspertët",
Hiqet fjalia Mënyra konkrete aktuale për rekrutimin e trajnerëve/ekspertëve parashikohet në ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", përfshi këtu edhe kushtet për përzgjedhjen e tyre.
 - Në pikën 3.2 Përzgjedhja e pedagogëve dhe trajnerëve/ekspertëve.
 - a) Hiqet togfjalëshi dhe trajnerëve/ekspertëve.
 - b) Hiqet fjalia: "Kjo Rregullore barazon, për efekt të kritereve të përzgjedhjes, stafin e pedagogëve të brendshëm të Shkollës me atë të pedagogëve të jashtëm të saj në procesin e Formimit Fillestar."

- c) Ndryshon fjalia: *Kjo do të thotë se Përzgjedhja e pedagogëve të brendshëm apo të jashtëm do t'u nënshtrohet kriterëve të mëposhtme, e cila bëhet Përzgjedhja e pedagogëve të brendshëm apo të jashtëm do t'u nënshtrohet kriterëve të mëposhtme:*
- c. Hiqet fjalia *Kjo Rregullore barazon, përsa i përket kriterëve, edhe procesin e përzgjedhjes së trajnerëve të Formimit Vazhdues, të cilët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme dhe shtohet pika 3.2/a Trajnerët e Formimit Vazhdues*
- d. Në pikën 3.2/a shtohet fjalia *Ekspertët e Formimit Vazhdues duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:*
- e. Në germën a) I. Hiqet lidhëza dhe
- f. Hiqet pika II e germës a).
- g. Në germën b) I. Hiqet lidhëza dhe
- h. Hiqet pika II e germës b).
- i. Në germën c) shtohet fjalia *Në përzgjedhjen e trajnerëve të Programit të Formimit Vazhdues kanë përparësi vitet e eksperiencës pedagogjike në Shkollën e Magjistraturës dhe si mësimdhënie universitare.*
- j. Në pikën 4 hiqet togfjalëshi, si dhe trajnerëve/ekspertëve/asistent pedagogëve.

2. Shtohet pika 7.3 Dispozitë kalimtare

- 1. Për trajnerët/ekspertët e miratuar përpara hyrjes në fuqi, verifikimi përqendrohet në përvojën profesionale mbi 10 vjet dhe ekspertizën e specifikuar në fushën përkatëse. Mungesa e përvojës pedagogjike ose të mësimdhënies nuk përbën shkak për çregjistrimin e tyre.
- 2. Procedurat e përzgjedhjes së trajnerëve, ekspertëve, moderatorëve dhe lehtësuesve, të filluara përpara hyrjes në fuqi të këtij Aneksi dhe për të cilat Këshilli Drejtues nuk ka marrë ende vendim përfundimtar, vazhdojnë dhe përfundojnë sipas kriterëve dhe rregullave të këtij Aneksi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë